

REZOLUTË
PËR INTEGRIMIN E SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Me vendosmërinë për të përmbushur objektivin madhor strategjik të integritit të Shqipërisë në Bashkimin European;

Me bindjen se Komunitetet Europiane përbëjnë bërthamën e vlerave të demokracisë, lirisë, bashkëjetesës në paqe e në stabilitet të qëndrueshëm;

Në mbështetje të përpjekjeve për krijimin e një shoqërie të begatë, nëpërmjet konsolidimit të ekonomisë së tregut dhe forcimit të vlerave të shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve shqiptarë;

I bindur se ky integrim do të shërbejë qenësisht si një kontribues aktiv në forcimin dhe stabilizimin e qëndrueshëm të situatës në Europën Juglindore, bashkëjetesës në harmoni dhe zhvillimit dinamik të rajonit, duke e çliruar atë përfundimisht nga kujtesat e hidhura të së kaluarës;

Nisur nga fakti që, nga pikëpamja gjeografike, historike dhe kulturore, Shqipëria, si vend european, qëndron në ndërthurjen e rrugëve, që lidhin Europën dhe kulturën europiane me hapësirën mesdhetare;

Bazuar

Në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit European, lidhur me procedurat dhe kushtet e kandidimit e më pas të anëtarësimit;

Ripërsërit gatishmërinë dhe vendosmërinë për vazhdimësinë dhe thellimin e punës tashmë të nisur për përafrimin e plotë të sistemit ligjor të Republikës së Shqipërisë me standardet dhe *l'acquis communautaire* të Bashkimit European, duke vënë në themel të kësaj pune bashkëpunimin më të gjerë dhe afatgjatë mes partive parlamentare të Shqipërisë;

Deklaron përkushtimin e tij për konsolidimin e vlerave të lirisë dhe të shtetit të së drejtës, garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të diversitetit kulturor dhe ruajtjes së identitetit kombëtar të çdo vendi;

Inkurajon Qeverinë e Republikës së Shqipërisë që, në momentin e përshtatshëm, në konsultim edhe me vendet anëtare të Bashkimit European, të paraqesë aplikimin e Shqipërisë për të kaluar si vend kandidat në këtë organizëm dhe të raportojë për këtë në Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë e negociatave;

Shpreson dhe mirëpret që Parlamenti European, vendet anëtare dhe institucionet e tjera të Bashkimit European të marrin në konsideratë vendosmërinë dhe konsensusin që ekziston mes të gjitha forcave politike të Republikës së Shqipërisë dhe aspiratës së popullit të saj, në lidhje me integrimin european, ashtu sikundër ato shprehen edhe në frymën e kësaj rezolute.

29 janar 2009